



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes Medina Brahaj, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
Nga:	Shkëlqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Data: 16/04/2018 Nr.020-423
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Shtimes	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Npi-01/66 për shpalljen e pronës me interes të përgjithshëm
I miratuar më datë: 29.03.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.04.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Naim Ismaili, gradonačelnik Opštine Štimlje Medina Brahaj, predsedavajuća Skupštine opštine Štimlje	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština-MALS	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>za</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljeja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 16.04.2018 Br.020-423
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Štimlje	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovana predsedavajuća

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Npi-01/66 za objavljivanje imovine od opšteg interesa
Usvojena dana, 29.03.2018., godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 05.04.2018. godine,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, nakon razmatranja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt iz proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-60/01-8851 datë:20.03.2018



Npi - 01/66 datë: 29.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 të datës 28 tetor 2010. Kryetari i Komunës së Shtimes, për qëllim të zgjerimit të rrugës "15 Janari" – Reçak, me shkresën Nr.06/42 dt.20.03.2018, i propozon Kuvendit të Komunës, shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-1; Me sipërfaqe prej 95m². (nëntëdhjetë e pesë metra katror); Zona Kadastrale Reçak; Evidentuar pronë e Azir (Riza) Smaili nga fshati Reçak.

Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë propozimin e Kryetarit si dhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, aprovoi këtë:

SEKULARNA INICIJATIVA
REPUBLIKË E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 05.04.2018
Date

Niveli organizativ	Nr i Lendës	Detyra	Shënime
-VI-	010-	423	

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën: 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-1; Me sipërfaqe prej 95m², (nëntëdhjetë e pesë metra katror); Zona Kadastrale – Reçak; Evidentuar pronë e Azir (Riza) Smaili nga fshati Reçak.

II

A r s y e t i m; Shpallja e pjesës së Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-1, me interes të përgjithshëm është bërë për qëllim të zgjerimit të rrugës "15 Janari" e cila të shpie te "Memoriali Përkujtimor i Masakrës së Raçakut".

III

Me këtë vendim obligohet ekzekutivi i Komunës së Shtimes që të fillojë procedurat e Shpronësimit, sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

[Handwritten signature]